



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më: 14.9.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit, Fadil Demaku, Qerim Bajrami, Zafir Berisha, Rexhep Selimi, Ganimete Musliu, Nuredin Ibishi dhe Bojan Mitiq, anëtarë.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Fjolla Uka-KDI.

Mbledhjen e kryesoi- Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Kryetari i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 22 dhe 29.07.2015;
3. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Fillimisht i njoftoi Komisionin për angazhimin e dy këshilltarëve në komision, z. Rifat Marmullakaj dhe z. Burim Ramadani, si dhe falënderoi për punën mbështetëse të stafit të komisionit. Më tutje vazhdoi me propozimin për miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 22.07.2015 dhe 29.07.2015;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor

Kryetari i Komisionit- Theksoi se plani i punës për pjesën tjetër të vitit është hartuar, ndërsa sa i përket ligjeve që do të shqyrtohen, kjo do të varet edhe nga dinamika e Qeverisë se kur do i procedojnë në Kuvend. Pasi plani aktual është më shumë i fokusuar në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Ndërsa rishikimi i buxhetit i paraparë në muajin nëntor, është propozuar nga këshilltarët të shqyrtohet në tetor.

Më tutje theksoi se është njoftuar për disa sjellje të oficerëve në kuadër të procesit të trajnimit të kadetëve të rinj, për sjellje që nuk janë në përputhje me normat, dhe se kjo është një arsyeje më tepër për të pasur FSK-ja komisionar, gjithashtu do të realizohet edhe një vizitë nga ana e komisionit.

Gjithashtu kemi pranuar vërejtje për Inspektoratin Policor të Kosovës, në baza paragjyqese i ndëshkon zyrtarët policorë. Ndërsa për Këshillin e Sigurisë Kombëtare, pasi si Komision nuk jemi në njohuri për aktivitetet e realizuara, do tu drejtojmë një letër për këtë qëllim. Raportin e një instituti (KIPRED), i cili i referohet takimit të informuar nga ana e Komisionit për AKI dhe Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyre të FSK-së. Kërkesa zyrtare nga ana e Komisionit për këtë takim është bërë, por nga ana e Komisionit për AKI është kthyer përgjigjja, që për shkak se informacionet që do të duhet të ndaheshin, janë të klasifikuara, takimi i përbashkët nuk mund të realizohet.

Fjalën ua dha anëtarëve të komisionit.

Zafir Berisha- Theksoi se plani i punës i paraparë për sesionin vjeshtor ka nevojë për plotësim. Konsideroj, që sa i përket sigurisë së vendit, në qytetin e Prizrenit, pasi kanë ndodhur disa raste të rënda, propozoj që në javët e ardhshme të kemi një pasqyrë nga ministri i Drejtësisë dhe ministri i Punëve të Brendshme, lidhur me atë se çfarë është duke ndodhur në Prizren. Pasi ka përplasje të deklaratave të zyrtarëve të lartë të drejtësisë dhe të policisë. Çështja tjetër për të cilën ka pasur debat ka qenë për FSK-në, pasi e dimë që nga ana e Qeverisë është iniciuar formimi i ushtrisë, por u ka mbetur ky proces? Prandaj konsideroj që në dy javët e ardhshme, të kemi informacione zyrtare se ku është procesi i formimit të Ushtrisë së Kosovës, pasi konsideroi që nuk jemi mjaftueshëm të informuar si anëtarë të komisionit.

Kryetari i Komisionit- Vlerësoi se kërkesa e parashtruar nga ana e z. Berisha është e drejtë dhe do të adresohet.

Fadil Demaku- Lidhur me planin e punës për sesionin vjeshtor, konsideroi që është më mirë që buxheti të shqyrtohet në muajin tetor dhe jo nëntor, ashtu siç edhe qenka propozuar të zhvendoset. Ndërsa sa i përket çështjeve të ngritura nga Kryetari për problemet e mundshme në FSK, IPK, mendoj se ne duhet t'i shikojmë si kërkesa dhe vërejtje dhe të jemi të kujdesshëm që këto mos të duken si konstatime të Komisionit, por pas takimit me këto institucione të jemi më të sigurt dhe t'i trajtojmë me kohë. Aktivitete shtesë në këtë plan do të varen edhe nga rrjedha e ngjarjeve dhe sfidat e mundshme.

Nuredin Ibishi- Vlerësoi që aspekt tjetër që do të shtonte, është aspekti i mbikëqyrjes i arkitekturës së sektorit të sigurisë, pasi nganjëherë trajtohen në mënyrë të ndarë, pasi takimet e përbashkëta me Komisionin e AKI-së dhe mbikëqyrja e institucioneve të tjera, do të bënte të kishim një pasqyrë më të mirë për këtë sektor. Çështja tjetër është mbikëqyrja e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, si dhe aspekti i mbikëqyrjes financiare të sektorit të sigurisë. Prandaj konsideroj që do të ishte mirë të kishim edhe tryezë për këtë qëllim, ku do të ftoheshin aktorë të ndryshëm. Ndërsa sa i përket mbikëqyrjes së Ligjit për Policinë, do të vazhdojmë me punën dhe të realizojmë takimet e parapara dhe të nxjerrim raportin përfundimtar.

Rexhep Selimi- Lidhur me mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit për Policinë e Kosovës në sesionin e kaluar dhe ngjarjeve që kanë ndodhur në qytetin e Prizrenit, konsideroi se do të ishim një hap para, sikur të realizohej agjenda për mbikëqyrjen e këtij ligji, ku ishte paraparë vizita në Komandën rajonale të Prizrenit. Kjo mund të realizohet në këtë sesion, por ne duhet të shikojmë se çfarë kemi lënë mangët, pasi nëse agjenda planifikohet ajo duhet të realizohet. Ndërsa sa i përket raportimit në Komision të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme, kjo mund të bëhet në një takim të përbashkët të dy komisioneve relevante. Shpresoj që në këtë sesion të jetë edhe projektligji për Komisionarin, ndërsa sa i përket ankesave të parashtruara në FSK-në, ne, si Komision do të mbikëqyrim zbatueshmërinë e ligjeve me të cilat punojnë. Sa i përket IPK-së, është bërë mbikëqyrja e ligjit dhe prapë janë vazhduar disa veprime kryeneçe në këtë institucion, ndërsa sa i përket buxhetit, nga takimet e realizuara, është kuptuar nevoja për mjete shtesë buxhetore për Policinë e Kosovës. Në mbyllje të fjalës uroi për punë të mbarë në këtë sesion.

Qerim Bajrami- Lidhur me kërkesën e ngritur nga z. Berisha për rastin e Prizrenit, vlerësoi se si komision duhet të gjetur mënyrën që sa më shpejt të merret përgjigjeje nga institucionet adekuate për këtë situatë.

Gjithashtu theksoi edhe një shqetësim nga komuniteti boshnjak, ku një parullë e shkruar në mur në një lagje ku jetojnë ky komunitet, ku është shkruar “vdekje për komunitetet që jetojnë këtu”. Për këtë çështje kemi kërkuar nga policia e Prizrenit, por nuk kemi marrë përgjigjeje. Propozoj që të kemi një vizitë në Komandën e Policisë në Prizren, si dhe pjesën ku jetojnë komuniteti boshnjak. Sa i përket Projektligjit për Letërnjoftim, theksoi se e ka një sqarim, por kjo do të jetë në të ndryshme.

Kryetari i Komisionit- Konsideroi se nga rekomandimet e dala t'i shkruhet letër ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Drejtësisë, lidhur me situatën në Prizren. Gjithashtu takimi i përbashkët mes dy komisioneve për të adresuar këtë problematikë do të ndërgjegjësonte organet kompetente. Gjithashtu propozoi që si komision të realizohet një vizitë në Prizren për të parë më afër situatën.

Ndërsa sa i përket ndryshimeve kushtetuese për transformimin e FSK-së në FAK-, theksoi se pasi ka marrë pjesë në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, pasi janë propozuar që ndryshimet kushtetuese të procedohen për seancë, nga ana e tij është kërkuar të dihet nëse është arritur marrëveshja për të marrë shumicën e votave. Pasi për këtë nuk është arritur konsensus, bashkërisht është vendosur që të procedohen në ditët në vijim.

Kryetari e konstatoi të miratuar planin e punës për sesionin vjeshtor

Më tutje propozoi që këtë të premte të realizohet vizita në Prizren, për të cilën gjë u akorduan edhe anëtarët e komisionit.

4. Të ndryshme

Qerim Bajrami- Lidhur me Projektligji për Letërnjoftimin, theksoi se qëndrimi i nënkryetarit të Kuvendit z. Xhavit Haliti, i cili ka konsideruar që projektligji si i tillë me propozimin e bërë është në kundërshtim me Kushtetutën. Theksoi se në kohën kur ka qenë në mandatin e kaluar nënkryetar i Kuvendit, Neni 9, në Ligji për përdorimin e gjuhëve zyrtare nga viti 2008, Ligj i cili është ende në fuqi me disa ndryshime, ku pika një e këtij neni shprehimisht është "formularët dhe letërnjoftimi shtypen në gjuhën zyrtare dhe gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa pika dy, "formularët dhe letërnjoftimet shtypen në alfabetin latin.

Ky ligj ka qenë në fuqi deri në vitin 2012 dhe është ende në fuqi, por në vitin 2012 duke e shfuqizuar mos bindjen e plotë përfaqësuesit e komunitetit boshnjak dhe turk, pasi kjo çështje është shqyrtuar shumë, ky nen është fshirë dhe në Nenin 9 i Ligjit bazik është riformuluar si në vijim" formularët dhe letërnjoftimet shtypen në gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Kur është pyetur drejtori i Departamentit Ligjor të Ministrisë, është thënë që nuk është bërë asgjë me qëllim, por është thënë që ky nen e përfshinë edhe këtë tekst, ndërsa nga ana e zyrtarit të kësaj drejtorie, ai e ka shpjeguar që një komunitet ka të drejtë, ndërsa komuniteti tjetër nuk ka të drejtë, pasi gjuha turke është gjuhë tradicionale, ndërsa gjuha boshnjake nuk është. Si komision gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Letërnjoftimin, kemi propozuar që ky nen të jetë më i qartë dhe të mos kufizohet vetëm në dy gjuhët që janë në përdorim në nivelin komunal. Pasi kur u kërkuar që edhe komuniteti boshnjak të ketë këtë të drejtë, që të shtypen letërnjoftimet në gjuhën boshnjake, thuhet që nuk është kjo e drejtë. Kjo çështje do të sqarohet edhe me Kryesinë e Kuvendit dhe për këtë qëllim kërkoj mbështetjen e juaj në grupet parlamentare.

Kryetar i Komisionit- Lidhur me deklarin e z. Bajrami theksoi se qëndrimet e secilit deputet janë të tyre, dhe mund tu drejtoheni drejtpërdrejtë, ndërsa sa i përket qëndrimit tim, si kryetar i Komisionit, e kam përkrahur propozimin e dhënë, që në disa komuna ku përqindja është në masën e caktuar mund të shtypen letërnjoftimet në gjuhën boshnjake, për komunitetin boshnjak.

Ndërsa qëndrimi i ministrisë së Punëve të Brendshme është se është e pa mundur implementimi i kësaj, nëse do të ketë më shumë se tre gjuhë, por zgjidhja varet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Rexhep Selimi- Konsideroi se nga ana e Komisionit është dhënë përkrahja për amendamentin e propozuar nga ana e z. Qerim Bajrami, ndërsa mos pjesëmarrja e grupit parlamentar të VV në seancë ditën kur është votuar ligji, ka qenë për arsye të tjera. Ndërsa sa i përket trajtimit të komuniteteve që jetojnë në Kosovë, kemi qenë dhe do të jemi të kujdesshëm në respektimin e të drejtave dhe këto të drejta të zbatohen në mënyrë të barabartë.

Çështje tjetër të cilën e ngriti ishte çështja e ndryshimeve Kushtetuese për shndërrimin e FSK-së në FAK. Duke qenë se ne nuk jemi Komisioni bartës, por çështja e shndërrimit të FSK-së në FAK ka qenë retorikë e Qeverisë. Kjo temë është kthyer në diskutim kur ishin në diskutim, siç ishte çështja e vendeve të rezervuara për komunitetin serb apo çështja e Gjykatës Speciale. Qeveria ka qenë në dijeni që me këtë përbërje në koalicionin qeveritar nuk mund të bëjë këtë ndryshim, andaj si Komision do të duhet të reflektojmë dhe të kemi qëndrime të qarta, ku çështja e shndërrimit të FSK-së në FAK të mos jetë lojë e retorikës politike.

Anton Quni- Theksoi se cilado Qeveri do të kishte të njëjtat probleme, që ka edhe Qeveria ekzistuese, duke tërhequr paralele me disa situata që kanë rastisur të jenë nuk është korrekte, pasi Qeveria e ka disponimin për transformimin e FSK-së në FAK, por i dimë limitet. Sa i përket kësaj çështje duhet të kemi unifikim dhe nëse nuk arrijmë të bëjmë kategori kushtetuese FAK-në duhet të gjinden alternativat ligjore, dhe këtë çështje kryeministri e ka potencuar.

Ndërsa sa i përket qëndrimit të z. Zafir Berisha, kur u shpreh që “Kryeministri nuk e dinë çfarë Fletë” kjo nuk është e vërtetë, pasi çdo njëri në këtë pozicion dhe autorizimet që i ka nuk mund të bëjë jashtë tyre. Për këtë temë nuk duhet të ekzistoj ndarje pozitive dhe opozitive, por të kërkohej mundësitë reale për ndërtimin e ushtrisë.

Zafir Berisha- Theksoi se çështja e krijimit të ushtrisë ka qenë “patate e nxehtë” mirëpo nuk duhet të torturohet opinioni me deklarata kush është për ose kundër kësaj çështje, por duhet parë mundësitë ligjore. Më tutje theksoi se pse domosdoshmërisht duhet ndërruar emri i FSK-së, ku mund të ndërrohet misioni i saj me kapacitete që ka, dhe nuk konsideroj se duhet bërë kompromise të radhës me Listën Serbe vetëm për ndërrimin e emrit.

Kryetari i Komisionit- Konsideroi se është e rëndësishme ndërrimi i misionit të FSK-së, nuk është e njëjtë, pasi deri sa nuk përfshihet në Kushtetutë nuk do të ketë të njëjtin efekt. Pasi ne kemi ushtrinë e cila është funksionale, por është Ministria e FSK-së është Ministri e integruar civile-ushtarake.

Rexhep Selimi- Theksoi se nuk është rastësi procedimi dy herë i amendamenteve kushtetuese për transformimin e FSK-së, herën e parë ka qenë në maj të vitit 2014, ku u janë sjellë në mënyrë të përsheptuar dhe ku si çështje e diskutueshme atë kohë ka qenë çështja e vendeve të rezervuara për komunitetin serb. Në momentin kur është dashur të votohen deputetët e komunitetit serb kanë qenë në kohë reale në Beograd, çështja është shtyrë pasi ata morën përgjigjeje, dhe amendamentet u hoqën nga rendi i ditës. E njëjta gjë ka ndodhur kur është propozuar edhe kur ka qenë çështja e Gjykatës Speciale. Tani çfarë duhet të bërë është ajo çfarë është dashur të bëhet nga

viti 2009, të pajiset FSK-ja në nivelin që i lejohet me Kushtetutë dhe me ligj, gjë që këtë nuk e kanë bërë kurrë. Është detyrë e Qeverisë për të ngritur kapacitete ushtarake të FSK-së.

Qerim Bajrami- Theksoi se kur është fjala te vendet e rezervuara kërkoi që me këtë çështje mos të përzihen komunitete e tjera siç janë, boshnjakët, turqit, romë, shkali dhe egjiptas, të cilët do të votojnë për çdo ndryshim për transformimin e FSK-së në FAK.

Fadil Demaku- Theksoi se çështja e cila u ngrit nga ana e z. Selimi, lidhur me qëndrimin e Qeverisë më shumë u duk si një konferencë për media, pasi kjo çështje është e të gjithëve dhe si anëtar i PDK-së them se vullneti është i madh për transformimin e FSK-së në FAK.

Rexhep Selimi-Theksoi se Komisioni duhet të ketë qëndrim në raport me manipulimet që po bëhen në FSK dhe të mos i përgjigjë sa herë që Qeverisë i teket për të sjellë si temë transformimin e FSK-së në FAK.

Anton Quni- Theksoi se duhet të rikujtojmë që nga legjislatura e kaluar, në vazhdimësi jemi njoftuar me ecurinë e procesit lidhur e transformimin e FSK-së në FAK, nga Ministria e FSK-së dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë proces, dhe kemi qenë të njoftuar me pengesat që mund të dalin. Ne duhet të mbajmë qëndrimin dhe të mbrojmë, por jo të identifikohemi si parti që disa e kanë këtë dëshirë ose jo, pasi kjo çështje është në agjendën kryesore të secilës parti.

Ganimete Musliu- Konsideroj se çështja e transformimit të FSK-së në FAK është temë e ndjeshme dhe duhet trajtuar me seriozitet dhe vëmendje, tashmë po e diskutojmë në pikën të ndryshme dhe propozoj që në mbledhjen e radhës të jetë pikë e rendit të ditës. Gjithashtu si Komision kemi të drejtën të kërkojmë informacione nga institucionet e përfshirë në këtë proces dhe të jemi të përgatitur për të diskutuar për këtë çështje.

Nuredin Ibishi- Theksoi se është përkushtim i Kryeministrit transformimi i FSK-së, ndërsa sa i përket fazës në të cilën ndodhemi në këtë proces për ndryshimet kushtetuese, theksoi se ka formë racionale të vijnë te ndryshimet dhe askush nuk mund ta ndalon krijimin e FSK-së si forcë multietnike.

Kryetari i Komisionit- Theksoi se këtë të premte të organizohemi për të shkuar në Prizren, ndërsa sa i përket çështjes së transformimit të FSK-së, ne, si Komision, jemi të gatshëm për të mbështetur procesin, pasi shihet një përgjumje e FSK-së. Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj